



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 579 Prot.

Tiranë, më 02.07.2020

VENDIM

Nr.49, datë 02.07.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 156, DATË 06.12.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA LIBOHOVË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 104, datë 30.10.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Libohovë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Libohovë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Libohovë, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 156, datë 06.12.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Libohovë, me shkresat nr.2037/1 prot., datë 12.02.2020 dhe nr.798 prot., datë 05.06.2020 ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Libohovë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Institucioni ka marrë masa dhe ka rikthyer gjendjen e ligjshmërisë për 11 punonjësit në vijim: *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****. Ndërsa për 1 rast nuk është kryer procesi i verifikimit pasi rezultojnë se punonjësi R. Telo ka dhënë dorëheqjen me aktin nr. 1686 prot, datë 29.10.2019 .
2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë është në pritje të caktimit të datës së zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për punonjësin *****.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 156, datë 06.12.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Libohovë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve

ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Libohovë.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Libohovë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha